



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.02.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 4/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:06 dhe mbaroi në orën 11:18.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës online*:

- | | |
|---------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)*</i> |
| <i>3. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)*</i> |
| <i>7. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)*</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *Birn.*
9. *Sidorela Driçi, Fakulteti i Drejtësisë (Universiteti i Tiranës).*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 4/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjjirokastër”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

Çelet mbledhja plenare nën drejtimin e zotit Rusi.

Ilir Rusi: Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të jetë prezent në këtë mbledhje, kështu që mbledhja do të drejtohet nga ana ime, Ilir Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu një pjesë e anëtarëve janë prezent në sallë: znj. Plaku, znj. Muçaj, z. Hado, znj. Muçi dhe unë, Iliri. Ndërsa një pjesë e anëtarëve të tjerë janë në lidhje online:

z. Koça, znj. Luli, z. Toro dhe znj. Rupa. Ndërsa zoti Kurushi për arsye shëndetësore nuk mund të jetë prezent në mbledhje (as në sallë, as online).

Për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, mbledhjen e deklaroj të hapur. Sipas rendit të ditës kemi dy pika rendi dite. Pika e parë është shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 4/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni Disiplinor. Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Me shkresën e datës 19.02.2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka depozituar për shqyrtim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Inspektori i Lartë ka propozuar caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj magjistratit z. {...} të parashikuar nga neni 111 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në referim të nenit 63 të Ligjit nr. 115/2016, lidhur me zhvillimin e procedurës, Komisioni Disiplinor propozon që të përfshihen tre anëtarë në përbërje të tij, që janë konkretisht anëtarët e Komisionit, Ilir Rusi, Gentiana Muçaj dhe Ridvan Hado.

Në vijim Këshilli duhet të procedojë me caktimin e mbledhjes plenare për të verifikuar nëse do të kalohet në seancë dëgjimore apo jo.

Për këto arsye pra, propozoj hedhjen në short të kërkesës, ndërmjet tre anëtarëve, Ilir Rusi, Gentiana Muçaj dhe Ridvan Hado.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Hado!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën në përgatitjen dhe hedhjen e shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e tre anëtarëve të Komisionit Disiplinor: Ridvan Hado, Gentiana Muçaj dhe Ilir Rusi.

Procedura e përzgjedhjes:

Për procedimin disiplinor nr. 4/2024, relator përzgjidhet z. Ilir Rusi.

Ilir Rusi: Ka diskutime mbi hedhjen e shortit?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Rusi: Znj. Luli!

Ilir Rusi: Z. Koça!

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Ilir Rusi: Nga komunikimi me administratën rezulton që zonja Luli e ka shprehur vullnetin, por për arsye teknike nuk dëgjohet zëri.

(Zonja Luli e ka shprehur votën e saj me shkrim nëpërmjet platformës. Bashkëlidhur procesverbalit të sigluar dokumenti përkatës.)

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 4/2024, të filluar nga inspektori i lartë i drejtësisë, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Ilir Rusi në cilësinë e relatorit për procedimin disiplinor nr. 4/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj

magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.02.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”/ “Për mbylljen e procedimit disiplinor nr. 03/2024, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”, përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:06 dhe mbaroi në orën 11:18.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës online*:

- 1. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 2. Fatmira Luli** (anëtare)*
- 3. Emona Muçi** (anëtare)
- 4. Ridvan Hado** (anëtar)
- 5. Irena Plaku** (anëtare)
- 6. Alban Toro** (anëtar)*

7. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
8. *Markelian Koça* (anëtar)*
9. *Yllka Rupa* (anëtare)*

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *Birn.*
9. *Sidorela Driçi, Fakulteti i Drejtësisë (Universiteti i Tiranës).*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”/ “Për mbylljen e procedimit disiplinor nr. 03/2024, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”, përparitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 2 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e

projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”/ “Për mbylljen e procedimit disiplinor nr. 03/2024, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni Disiplinor. Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Me shkresën e datës 15.02.2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka depozituar për shqyrtim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesën me objekt fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka propozuar caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj magjistratit z. {...} të parashikuar nga nenet 105, pika 1, shkronja dh dhe 111 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Me shortin e datës 20.02.2024, me nr. vendimi 92, jam caktuar unë si relator i kësaj çështjeje.

Jeni njohur pak a shumë me faktet e parashtruara/pretenduara nga ILD.

Referuar nenit 31 të rregullores për procedurën disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor u bënë verifikimet e ekzistencës së rasteve të parashikuara nga neni 139 i ligjit “Për statusin”. Rezulton që referuar nenit 117 raporti i hetimit rezulton se është brenda afatit 5-vjeçar. Çështja nuk ka qenë objekt i një procedimi disiplinor të zgjidhur me vendim të formës së prerë; Nuk ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronja “ç” dhe “d” të ligjit “Për statusin”; Raporti i hetimit është depozituar i arsyetuar në përputhje me parashikimet e pikës 3 të nenit 138 të ligjit “Për statusin”.

Sa më sipër, në mbledhjen e datës 22.02.2024, Komisioni Disiplinor, pasi dëgjoji relatimin e çështjes dhe u njoh me relacionin si dhe aktet e dosjes hetimore, vendosi

kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të vlerësuar nga ky i fundit kalimin e çështjes në seancë dëgjimore dhe për caktimin e datës.

Në përfundim, si relator i çështjes, i propozoj mbledhjes plenare që çështja të kalojë për shqyrtim në seancë dëgjimore, ku duhet të kemi parasysh afatin njëmuajor dhe afatin e njoftimit 15-ditor. Kjo çështje është regjistruar më datë 15.02.2024.

Ju faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Ka diskutime për sa u propozua?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime në lidhje me propozimet e zotit Hado për të kaluar këtë çështje në seancë dëgjimore, njëkohësisht do të ftoja po zotin Hado për të parashtruar edhe datën dhe orën e mbajtjes së kësaj seance dëgjimore.

Ridvan Hado: Nëse kolegët do jenë dakord, unë propozoj si datë, datën 13 mars 2024, ora 11:00, që është ditë e mërkurë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Ka diskutime mbi propozimin e dytë të z. Hado?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, kalojmë në votimin e këtij projektvendimi, duke marrë në konsideratë dy propozimet e zotit Hado.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e datës 13.03.2024, ora 11:00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

Ilir Rusi: Me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Fundjavë të qetë.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor